

## Martin Heideggers Rhetorik des Seins

Prishtina, 18. Mai 2016; rechts: Übersetzung ins Albanische von **Kristë Shtufi**

*von Martin Ross (Kunstuniversität Linz)*

(1)

2014, also vor zwei Jahren, ist ein bedeutendes Buch über Martin Heidegger erschienen: Helmuth Vettters »Grundriss Heidegger«. Dieses Buch ist ein Herkules-Projekt: Es versucht nichts weniger als eine Gesamtdarstellung des Denkens Martin Heideggers auf der Basis aller bis 2014 veröffentlichten Werke dieses einflussreichen deutschen Philosophen; und es kann mit Fug und Recht gesagt werden, dass Helmuth Vetter das gelungen ist. Meine heute und hier vorgetragenen Überlegungen verdanken sich zu einem großen Teil seinem Buch. Sie stammen aber auch aus meiner nunmehr über 30-jährigen – und weiterhin andauernden – Beschäftigung mit der Philosophie Martin Heideggers. Am meisten beschäftigt mich seine Ästhetik (den Ausdruck »Ästhetik« würde Heidegger allerdings zurückweisen), sein Umgang mit Kunst und Dichtung, aber – vor allem wenn man die Dichtung betrachtet – auch sein Umgang mit Sprache. Damit meine ich nicht die Bedeutung, die etwa Friedrich Hölderlins Lyrik für ihn hat, sondern Heideggers sehr spezielle Art, mit Sprache umzugehen, Sprache zu verwenden.

Ich habe einen dezidiert handwerklichen Zugang zur Sprache in der Philosophie. Das durchzuhalten ist nicht immer einfach, einerseits weil das Handwerkliche, das Naheliegende, das Einfache von der Institution Philosophie mit ihren Kongressen, Publikationsmedien, Instituten nicht gerne gefördert wird, andererseits, weil es einem die Philosophen

## Retorika e të qenmes te Martin Hajdegeri

Prishtinë, 18 maj 2016; nga gjermanishtja përktheu në shqip: **Kristë Shtufi**

*Martin Ross (Universiteti i Arteve, Linz, Austri)*

(1)

Në vitin 2014, pra dy vjet më parë, është publikuar një libër i rëndësishëm në lidhje me Martin Hajdeger: libri i Helmut Feter (Helmuth Vetter) “Grundriss Heidegger” (Skicë e Hajdegerit). Ky libër është një projekt i vështirë: Ky libër nuk synonte asgjë më pak se një prezantim të përgjithshëm të mendimit të Martin Hajdegerit, në bazë të të gjitha veprave të publikuara deri më 2014 të këtij filozofi gjerman me ndikim; dhe mund të thuhet me arsye të plotë që Helmuth Vetter ka pasur sukses. Mendimet e mia që po i paraqes këtu në një pjesë të madhe ia dinë për nder librit të tij. Por, ato gjithashtu vijnë edhe nga fakti se jam marrë me studimin e filozofisë së Hajdegerit tani për më shumë se 30 vjet – dhe ende merrem me të në vazhdimësi. Më së shumti më intereson estetika e tij (termin “estetikë” Hajdegeri, megjithatë, do ta refuzonte), mënyra se si merret ai me art dhe poezi, por – veçanërisht kur merret parasysh vjershërimi – atëherë edhe përdorimi i tij i gjuhës. Me këtë nuk nënkuptoj rëndësinë që ka për të, për shembull, lirika e Friedrich Hölderlin, por mënyra shumë e veçantë e Hajdegerit se si sillet me gjuhën, si e përdor gjuhën.

Unë kam një qasje të vendosur artizanale lidhur me gjuhën në filozofi. Që t’i qëndroj kësaj qasjeje deri në fund nuk është gjithmonë e lehtë, pjesërisht për shkak se artizanalja, ajo që është më e afërta, e thjeshta, nuk mbështetet nga institucioni filozofi me kongreset e saj, me mediat e publikimit, me departamentet, në anën tjetër, për shkak se filozofët –

– und gerade Heidegger! – nicht immer leicht machen, einen Zugang zum jeweiligen Denken zu finden. Helmuth Vetter schreibt:

»Mindestens vier Momente erschweren den Zugang zu Heideggers Texten: 1. Sprachliche Besonderheiten, 2. die Art der Interpretation, 3. die Gewaltsamkeit, 4. die Zweideutigkeit.« (S. 22)

Zum ersten Moment: Vetter listet ein paar dieser sprachlichen Besonderheiten auf, darunter finden sich nicht nur Fremdwortneologismen, sondern auch deutsche Wörter, die nicht nur für sich betrachtet ungewöhnlich und alltagssprachlich ungebräuchlich sind, sondern auch in der Art und Weise, wie Heidegger sie verwendet – selbst in einfachen Aussagesätzen: ›Geworfenheit‹, ›Jemeinigkeit‹, ›welten‹, ›nichten‹, ›dingen‹. Es ist auch für deutschsprachige Ohren ungewöhnlich zu hören, dass »das Ding dingt« (GA 7, 165–184). Woher dieser Sprachgebrauch kommt, möchte ich zu zeigen versuchen.

Einer der Herkunftsgründe mag im zweiten von Vetter erwähnten Moment liegen: »Heideggers Art zu interpretieren ist an Sorgfalt oft kaum zu übertreffen.« (Vetter, S. 23). – Das ist ein wahrer Satz. Was er anspricht, reicht von Heideggers Auslegungen klassischer philosophischer Texte wie dem Höhlengleichnis Platons (GA 34) über sein Hölderlin-Verständnis (GA 4, GA 52 und andere) bis hin zur Interpretation einzelner Begriffe wie etwa »alétheia« oder »physis« oder »téchne«. Man mag vielleicht inhaltlich mit Heideggers Interpretationen nicht übereinstimmen, dass sie aber beinahe schmerzhaft sorgfältig sind, das kann niemand ernsthaft bestreiten. Wer wie Martin Heidegger so genau mit jenen Texten umgeht, die ihm zu denken geben, der hat ein ganz besonderes und besonders enges Verhältnis zur Sprache.

dhe pikërisht Hajdegeri! – nuk ia lehtësojnë njeriut punën për të gjetur një qasje të menduarit të tyre. Helmuth Vetter shkruan:

“Të paktën katër momente e vështirësojnë qasjen në tekstet e Hajdegerit: 1. karakteristikat e veçanta gjuhësore, 2. lloji i interpretimit, 3. Dhunshmëria, 4. dykuptimësia” (fq 22)

– Lidhur me pikën e parë: Vetter rendit disa nga këto karakteristika të veçanta gjuhësore, duke përfshirë jo vetëm neologjizmat nga gjuhët e huaja, por edhe fjalë gjermane që jo vetëm për veten e tyre konsiderohen se janë të pazakonta dhe në gjuhën e përditshme të papërdorshme, por edhe në mënyrën se si Hajdegeri i përdor ato – madje edhe në fjali të thjeshta deklarative: ‘hedhja’ (gjerm. ‘Geworfenheit’), ‘në-çdo-rast-e-imja’ (gjerm. ‘Jemeinigkeit’), ‘botëroj’ (gjerm ‘welten’), ‘asgjësoj’ (gjerm. ‘nichten’), ‘sendoj’ (gjerm. ‘dingen’). Është e pazakontë edhe për veshët e një gjermano-folësi për të dëgjuar se “sendi sendon” (gjerm. ‘das Ding dingt’) (GA 7, 165–184). Se nga vjen ky përdorim gjuhësor, kjo është ajo që do të përpiqem ta tregoj këtu.

– Një nga arsytet e origjinës mund të qëndrojë në momentin e dytë që ka përmendur Vetter: “Mënyra e Hajdegerit për të interpretuar me kujdes shpesh është e vështirë për t’u tejkaluar” (fq. 23). – Ky pohim është një pohim i vërtetë. Ajo që ai thotë, përfshin duke filluar nga interpretimet e Hajdegerit që ua bën teksteve klasike filozofike, si Alegoria e Shpellës e Platonit (GA 34) pastaj duke vazhduar te të kuptuarit e tij për Hölderlin-in (GA 4, GA 52 dhe të tjerët) dhe deri te interpretimi i termave të caktuara të tilla si “alétheia” ose “physis” ose “téchne”. Ndoshta ndokush mund të mos pajtohet përmbajtësorisht me interpretimet e Hajdegerit, por faktin se ato interpretime janë pothuajse të bëra me kujdes të tepruar, këtë nuk mund ta mohojë seriozisht askush. Ata që i trajtojnë ato tekste me saktësi ashtu si Martin Heideggeri, të cilat i japin shkas të mendojë, ai ka një raport shumë të veçantë dhe shumë të ngushtë me gjuhën.

Kurz noch zu den verbliebenen zwei Momenten, die Vetter anführt, auf die es mir aber nicht ankommt. Zunächst: Gewaltsamkeit.

– 3) »Heideggers Gewaltsamkeit hat die Aufgabe, das alltägliche Vorverständnis in Frage zu stellen [...] Die Interpretation bedarf der Gewalt, denn das Dasein neigt konstitutiv zum Verfallen. Dies betrifft nicht nur den Alltagsverstand, sondern auch die Dogmen der philosophischen Überlieferung [...].« (S. 23) Gewalt ist hier nicht im zerstörerischen, vernichtenden Sinn zu verstehen, sondern eben darin, nicht hinterfragte Vorverständnisse in Frage zu stellen, sie zu befragen (be-fragen; mit Bindestrich), letztlich zu destruieren, also ihre Struktur aufzulösen, um von Dogmen weg- und zu möglichst sachgemäßen Aussagen hinzukommen. Auf diesen Aspekt kann ich aus Zeitgründen nicht eingehen, und auch nicht auf den vierten und letzten Aspekt, die Zweideutigkeit.

– 4) »Das Philosophieren überhaupt ist zweideutig. Denn es kann zwar als Wissenschaft oder Weltanschauung auftreten, unterscheidet sich aber von beiden, zumal von deren Vermischung.« (S. 24) Es würde zu weit führen, dies hier ausführlich darzulegen, nur so viel: Es geht darum, dass eine philosophische Lehre (und ihre Rezeption) zweideutig ist, weil es sich bei den von ihr verwendeten Begriffen zunächst stets um die von Heidegger so genannte »formale Anzeige« (GA 61, 141 [Vetter 46]) geht, also um etwas Vermeintes, Vorgestelltes usw. – somit um etwas Sprachliches. Formal wird etwas angezeigt, wenn man einen sprachlichen Ausdruck dafür findet, es wird also lediglich denotativ gesagt, es handle sich um dies und das; es wird aber nicht notwendigerweise auch gesagt, was dies und das SEI. Weder das Sein noch das Sagen sind hier thematisch, darauf aber kommt es Heidegger an. Damit komme ich zum eigentlichen Thema meines Vortrags, zur Rhetorik, und ich schließe an Veters erstes und zweites Moment an: neue Wörter, sorgfältige Interpretation.

Vetëm shkurtimisht lidhur me dy momentet e mbetura, të cilat i rendit Vetter, por që nuk janë të rëndësishme për mua këtu. Së pari: dhunshmëria.

– 3) “Dhunshmëria e Hajdegerit ka për detyrë që të vë në pikëpyetje opinionet e përditshme të parakconceptuara [...] Interpretimi kërkon dhunshmërinë, për arsye se ekzistenca tenton të kalbet në mënyrë konstitutive. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me mendjen e shëndoshë, por edhe me dogmat e traditës filozofike [...]” (fq. 23) Dhunshmëria këtu nuk duhet kuptuar si diçka asgjësuese dhe shkatërruese, por vetëm si diçka që vë në pikëpyetje opinionet e parakconceptuara, që i diskuton ato, dhe që në fund i destruktion ato, pra e shkrin strukturën e tyre, me qëllim që kështu të largohemi nga dogma dhe të arrijmë te pohimet objektive. Nuk mund të thellohem më shumë në këtë aspekt për mungesë kohe, dhe as në aspektin e katërt dhe të fundit, te dykuptimësia.

– 4) “Të filozofuarit vetë është i dykuptimshëm. Sepse, ndërsa ai mund të duket si një shkencë apo botëkuptim, por ndryshon nga të dyja, sidomos nga përzierja e tyre” (fq. 24) Ajo do të marrë shumë kohë, që të shpjegohet në detaje këtu, por le të themi vetëm edhe kaq: Bëhet fjalë për atë se një doktrinë filozofike (dhe recepcioni i saj) është e dykuptimshme, sepse te nocionet që përdor ajo pikësëpari gjithmonë bëhet fjalë për atë që Hajdeger e quan “tregues formal” (GA 61, 141 [Vetter 46]), pra, për diçka të supozuar, diçka të marrë me mend etj. – pra, për diçka gjuhësore. Diçka shfaqet në mënyrë formale kur gjendet një shprehje gjuhësore për të, pra thuhet thjesht në mënyrë denotative se bëhet fjalë për këtë apo atë gjë; por jo domosdoshmërisht thuhet se çfarë QENKA kjo apo ajo. Këtu nuk është tematikë as e qenmja as e thënmja, por për Hajdegerin kjo është me rëndësi. Kjo më sjell tek tema e fjalimit tim, te retorika, dhe këtu lidhem me momentin e dytë të Vetter-it: fjalët e reja, interpretim i kujdesshëm.

(2)

Rhetorik als eine besondere sprachliche Kunstfertigkeit hat es nicht leicht. Wohl wegen der fatalen politischen Tendenzen des vergangenen Jahrhunderts – Faschismen und Totalitarismen jeglicher Art –, die ausgiebig Werkzeuge der Rhetorik verwendet haben, um ihre Morde zu legitimieren, wird sie kritisch beäugt und nicht immer positiv gesehen und bewertet. Dabei ist Rhetorik, neben Vielem anderen auch, eine Kunstfertigkeit, die aufs sprachliche Überzeugen zielt, und nicht aufs Überreden, wie man immer noch glaubt. Es geht ihr um das Klar-, um das Durchsichtig- und Verständlich-Machen von Gedanken. Dieses Überzeugen bedient sich aller Werkzeuge, die einem sprachlich zur Verfügung stehen – Logik, Stilistik, Topik, Dispositionen- und Argumentationslehre; um nur ein paar ihrer Bestandteile zu nennen. Vor allem aber geht es primär nicht ums Sprechen im Sinne der mündlichen Rede, sondern um Sprache in ihrer schriftlichen Darstellungsform. Egal ob man schreibt oder spricht: Man hat doch immer ETWAS zu sagen, und das ist in der Regel aufgeschriebener Text, festgehaltene Sprache. WIE man das tut oder tun kann, dafür hat sich im Lauf der Jahrhunderte eine Art Regelwerk entwickelt, das sich allerdings in seinen Grundzügen seit Aristoteles und Cicero kaum verändert hat; das ist sein nicht hoch genug einzuschätzender Vorteil. Mein Anknüpfungspunkt ist ein rhetorisches Phänomen, das die enge Verbindung der Rhetorik mit der Philosophie zeigt: das sogenannte »res-verba-Problem«. Es stammt aus dem Bereich der Texterstellung und reflektiert die Frage, was denn zuerst sei: die Sache (res) oder die Worte (verba), die diese Sache bezeichnen. Schon der Nebensatz »die diese Sache bezeichnen« zeigt deutlich, dass es ein temporales Verhältnis zwischen res und verba zu geben scheint, das eine zeitlich früher als das andere, jenes also dieses bedingend. Für den Arbeitsprozess des Schreibens eines Texts ist es eine relevante Frage, ob es so eine faktische, temporal hierarchische Beziehung zwischen res und verba gibt, betrachtet man aber das Phänomen der Sache-Wort-Beziehung

(2)

Retorika si një shkathtësi e veçantë gjuhësore nuk e ka edhe aq lehtë. Dhe pikërisht, për shkak të tendencave fatale politike të shekullit të kaluar – fashizmit e totalitarizmit të çdo lloji – që kanë përdorur gjerësisht mjetet e retorikës, ajo është parë në mënyrë kritike dhe nuk shihet dhe nuk vlerësohet gjithmonë në mënyrë pozitive. Por retorika, përveç shumë aspekteve të tjera, është shkathtësi që synon të bindurit gjuhësor, dhe jo të bindurit ashtu si besohet akoma. Për retorikën është me rëndësi që t'i sqarojë, t'i bëjë të dallueshme dhe të kuptueshme mendimet. Ky lloj i të bindurit përdor të gjitha mjetet që ka gjuhësisht në dispozicion – logjikën, stilistikën, topikën, mësimin mbi dispozicionet dhe mbi argumentimin; këto sa për të përmendur vetëm disa nga komponentët e saj. Mbi të gjitha, nuk është fjala në mënyrë primare për të folurit në kuptimin gojor, por për gjuhën në formën e prezantimit të saj të shkruar. Pa marrë parasysh a shkruajmë a flasim: Gjithmonë kemi DIÇKA për të thënë, dhe ajo zakonisht është një tekst i shkruar, një gjuhë e konstatuar. SI bëhet kjo aktualisht ose si mund të bëhet, për këtë qëllim është zhvilluar në rrjedhën e shekujve një lloj sistemi i rregullave, por i cili nuk ka pësuar ndryshim pothuajse aspak që nga Aristoteli dhe Ciceroni; kjo është përparësia e tij që nuk mund të vlerësohet mjaft lart. Pika ime fillestare është një fenomen retorik, që tregon lidhjen e ngushtë të retorikës me filozofinë: të ashtuquajturin "problem-res-verba". Ky problem vjen nga fusha e prodhimit të teksteve dhe reflekton pyetjen se cila vjen e para: sendi (res) apo fjalët (verba), të cilat i referohen këtij sendi. Veç edhe fjalja e varur 'të cilat i referohen këtij sendi' tregon qartë se duket që ekziston një marrëdhënie temporale ndërmjet res dhe verba, e para më e hershme se e dyta, duke e kushtëzuar, pra, e para të dytën. Për procesin e punës së të shkruarit të një teksti, një çështje e rëndësishme nëse në atë mënyrë ekziston një marrëdhënie e tillë faktike hierarkike temporale mes res dhe verba, por kur shikojmë më për së afërmi fenomenin e marrëdhënies send-fjalë, atëherë edhe retorika klasike e

näher, so weiß auch die klassische Rhetorik sehr genau, dass eine Trennung der gedanklichen von den sprachlich-stilistischen Aspekten im Grunde nicht möglich ist, weil sie untrennbar miteinander verbunden sind. In der Rhetorik ist es eben NICHT so, dass sie davon ausgeht, dass es so etwas wie eine vorsprachlich existierende Welt der Phänomene gibt. Die Phänomene sind nicht vor, sondern in und mit der Sprache. Und es ist der Mensch, der in und mit der Sprache denkt. Heidegger hat das sehr genau gewusst, und das mag für ihn mit ein Grund gewesen sein, das Problem des Seins in der klassischen Metaphysik neu zu überdenken. Das deutsche Wort ›Sein‹, besser: ›sein‹ (›zu sein‹, als Verb zu lesen/hören) ist im Rahmen des rhetorischen res-verba-Problems ein besonders schwieriges Wort. Ihm und vor allem dem ›Sinn von Sein‹ gelten die folgenden Überlegungen.

(3)

Der Kern von Martin Heideggers Rede vom Sein ist sein allgemein bekannter Ausgangspunkt der »ontologischen Differenz«, ein Ausdruck, den er geprägt hat und den er in »Sein und Zeit« (GA 2) entwickelt hat: »Sein« ist etwas anderes als »Seiendes«. Schon allein dadurch, dass man rein aus sprachlichen Gründen gehalten ist, »Sein« als »Etwas« – also gleichsam als ein Ding – zu bezeichnen (wie soeben hier geschehen), zeigt, wie stark verwurzelt »Seiendes« in der alltäglichen Rede ist. Sein, das allem Seienden vorausgeht, bietet uns erst den Verständnishorizont für all das, was uns in der Welt begegnet, eben für das Verstehen von Seiendem. Auf eine gewisse Weise ist Sein nicht sichtbar, auch wenn es wirksam ist, also da sein muss; vorhanden sein muss.

Ein Beispiel bei Heidegger ist das Geben (in Form des »es gibt«): Was mir gegeben worden ist, also Gegebenes, ist seiend. Der Geber jedoch und das Geben sind nicht sichtbar. Selbst im Moment der Gabe, im

di shumë saktë se në parim nuk ekziston një ndarje mes aspekteve të mendimit dhe atyre gjuhësore-stilistike, sepse ato janë të lidhura mes vete në mënyrë të pandashme. Në retorikë, pikërisht NUK është ashtu që ajo të supozojë se ekziston diçka e tillë si një botë e fenomeneve, e cila ekziston para gjuhës. Fenomenet nuk ekzistojnë para gjuhës, por janë në gjuhë dhe me gjuhën. Dhe pikërisht njeriu është ai që mendon në gjuhë dhe me gjuhën. Hajdegeri këtë e ka ditur shumë të mirë, dhe kjo mund të jetë për të edhe një arsye tjetër për të rimenduar problemin e të qenmes në metafizikën klasike. Fjala gjermane 'e qenmja' ('Sein'), më mirë: 'me qenë' ('sein'), (të lexohet/dëgjohej 'me qenë' si folje) në kuadër të problemit-res-verba është një fjalë veçanërisht e vështirë. Kjo fjalë dhe para së gjithash 'kuptimi i të qenmes' janë objekt i shqyrtimeve të mëposhtme.

(3)

Thelbi i bisedës së Martin Hajdegerit mbi të qenmen është pikënisja e tij e njohur e "dallimit ontologjik", një shprehje kjo që e ka shpikur ai dhe që e ka zhvilluar ai në veprën "E qenmja dhe koha" (GA 2): "E qenmja" ("Sein") është diçka tjetër për dallim nga "entiteti" ("Seiendes"). Fakti i thjeshtë se jemi të detyruar vetëm edhe për arsye gjuhësore që ta quajmë "të qenmen" ("Sein") si "diçka" – pra pothuajse si send – (siç posa ndodhi pikërisht këtu) tregon se sa thellë është e rrënjosur "e qenmja" në gjuhën e përditshme. E qenmja që i paraprin të gjitha entiteteve (gjerm. "allem Seienden"), vetëm sa na jep horizontin e kuptimit të gjithçkaje që hasim në botë, pikërisht përmes të të kuptuarit të entiteteve (gjerm. von Seiendem). Në njëfarë mënyre të caktuar e qenmja nuk është e dukshme, madje edhe kur ajo është efektive, pra kur duhet të jetë këtu; kur duhet të jetë e pranishme.

Një shembull te Hajdeger është dhënia ("është e dhënë ose ekziston"): Ajo që më është dhënë, pra e dhëna, është. Megjithatë, dhënësi dhe

Moment des Gebens, also wenn mir jemand etwas gibt, etwas überreicht, dann ist das Geben als solches nicht sichtbar, weil es eben ein Vorgang, ein Tun ist. Es ›ist‹, aber es ist nicht wie ein Seiendes, nicht wie ein Ding. Es geht also um das Einzelne, um das Ganze UND um den Bezug, der zwischen beiden existiert, anders gesagt: Das Sein ist stets vor- und mitgänglich im Umgang mit der Welt. Da das Sein aber selbst nichts Seiendes, sprich Dingliches ist, lässt sich nicht so ohne weiteres sagen, dass das »Sein ist«. Heidegger benützt deswegen, um den Ausdruck »Sein ist« zu vermeiden, die Formel »es gibt Sein« oder auch »das Sein west« (GA 2; GA 8, 192; GA 9, 334; GA 14 und andere). Das Sein ist der unthematische Horizont, der immer anwesend ist, vor dem sich die Einzeldinge in ihrer sinnhaften Bedeutung zeigen. Insoferne sind für Heidegger Sein und Verstehen zwar nicht dasselbe, aber in eins gesetzt. Das Sein ist für ihn der Verstehenshorizont, vor dem sich das Verstehen von Seiendem ereignet. Die Aufgabe des Philosophierens wäre, so lässt sich angesichts von Heideggers Denken sagen, das unthematisch Mit-anwesende thematisch zu machen, es zu einem eigenen Thema zu machen, es ins Ausdrückliche zu bringen: ihm eine eigene Sprache zu geben, die ihren eigenen Regeln folgt, ihre eigene Rhetorik hat. Das mitgemeinte und mitgedachte Sein soll eigens gedacht werden. Mit Hilfe der Alltagssprache sei das nicht möglich. Warum?

Die Antwort ist: Weil sich die Alltagssprache immer nur auf Seiendes bezieht und beziehen kann – und nicht auf einen Verständnishorizont. Das ist auch der Grund, warum Heidegger ein neues philosophisches Vokabular entwickelt hat, das selbst für deutschsprachige Muttersprachler nicht immer leicht zu verstehen ist. Sicher, die einzelnen Worte, Neologismen, die er gefunden und manchmal auch erfunden hat, sind für sich genommen einfach und gut zu verstehen, und auch in ihrer grammatikalischen Anwendung zwar ungewohnt, aber doch verständlich. Was es schwierig macht, seinen neuen deutschen Wörtern zu folgen, ist ihre rhetorische Anwendung. Heidegger versucht nämlich,

dhënia nuk janë të dukshme. Edhe në momentin e dorëzimit, në momentin e dhënies, pra, ku dikush më jep diçka, më dorëzon diçka, në atë rast dhënia si e tillë nuk është e dukshme, për shkak se ajo është një proces, vetëm një akt. Ajo ‘është’, por ajo nuk është si entitet (gjerm. Seiendes), nuk është si send. Pra, bëhet fjalë për individualen, të tërësishmen DHE për lidhjen që ekziston me atyre dyjave, me fjalë të tjera: e qenmja (gjerm. Sein) është gjithmonë para dhe gjatë trajtimit të botës. Por, meqenëse e qenmja (gjerm. Sein) vetë nuk është entitet (gjerm. Seiendes), përkatësisht nuk është diçka sendore, nuk mund të themi aq lehtë se “e qenmja ekziston” (gjerm. “Sein ist”). Për këtë arsye Hajdegeri, me qëllim që të shmang shprehjen “e qenmja është” (gjerm. “Sein ist”), e përdor formulën “ka të qenme” (gjerm. “es gibt Sein”) ose edhe “e qenmja është pranë” (gjerm. “das Sein eest”) (GA 2; GA 8, 192; GA 9, 334; GA 14, dhe të tjerët). E qenmja është horizonti jotematik, i cili është gjithmonë i pranishëm, para të cilit sendet individuale tregohen në rëndësinë e tyre kuptimplotë. Në këtë kuptim të Hajdegeri e qenmja dhe të kuptuarit nuk janë të njëjta, por të vendosura në një. E qenmja për të është horizonti i të kuptuarit, para të cilit ndodh të kuptuarit e entitetit (gjerm. Seiendem). Siç mund të shihet nëse marrim parasysh mendimin e Hajdegerit, detyra e filozofisë do të ishte që ta tematizojë atë që është e pranishme jotematikisht, ta bëjë temë të veten, ta sjellë në të shprehshmen: t’i japë një gjuhë të veten, që shkon sipas rregullave të saj, që ka retorikën e vet. E qenmja e kuptuar njëkohësisht dhe e menduar aty duhet të mendohet në mënyrë të posaçme. Kjo s’do të ishte e mundur me ndihmën e gjuhës së përditshme. Pse?

Përgjigja është: Sepse gjuha e përditshme gjithmonë i referohet dhe mund t’i referohet vetëm entiteteve – dhe jo një horizonti të të kuptuarit. Kjo është edhe arsyeja pse Hajdegeri ka zhvilluar një vokabular të ri filozofik, i cili edhe për vetë folësit e gjuhës gjermane nuk është gjithmonë i lehtë për t’u kuptuar. Sigurisht, fjalët individuale, neologjizmat që ai ka gjetur dhe ndonjëherë edhe shpikur,

die verdinglichende Tendenz von Sprache – die, zugespitzt gesagt, bestrebt ist, etwas als Etwas zu bezeichnen – zu unterlaufen und vom Phänomen des Seins auf eine nichtverdinglichende Weise zu sprechen. So kommen seltsame Formulierungen zustande, die man halb beschreibend, halb abschätzig ›heideggern‹ (als Verbum) genannt hat. Man mag dazu stehen, wie man will, Martin Heideggers spezielle Seinsrhetorik zeigt, wie sehr er mit der überlieferten Sprache gerungen hat.

Ich bringe zwei – vielleicht bekannte – zusammenhängende Beispiele von philosophischen Übertragungen altgriechischer Begriffe ins Deutsche. Zuerst das Wort ›physis‹. Dabei handelt es sich um ein sogenanntes ›deverbatives Nomen‹, also um ein Substantiv, das von einem Verb abgeleitet ist, von ›phyein‹, das ist ›aufgehen, entstehen, werden, wachsen‹. Die korrekte lateinische Übersetzung ist ›natura‹, und so ist es auch in die modernen Sprachen gekommen: Natur, nature (en, fr), natura (it, pt, sp) etc. Modern verwendet, wird Natur als Gegensatz vor allem zu ›Kunst‹ verstanden, oder zu ›Geist‹. Es bedeutet aber auch die ›Natur einer Sache‹, das ›Wesen einer Sache‹. Und sobald von ›Wesen‹ die Rede ist, befinden wir uns mitten in der Seinsrhetorik Heideggers.

Natur, also ›physis‹ ist nicht einfach so wie ein (Natur-)Gegenstand, sondern gerade indem ›physis‹ von einem Verb abstammt, also von einem Wort, einem sprachlichen Ausdruck abstammt, der ein Geschehen, einen Vollzug bezeichnet, ist klar, dass man mit einer nominalistischen Begriffsbestimmung, die im Wortsinn eine Definition, eine Um-Grenzung beabsichtigt, im Verständnis nicht weiterkommt. Es kann also nur ein Verständnis von ›physis‹ geben, das die Beweglichkeit des Phänomens, seinen Vollzugscharakter hervorhebt. Das wird erschwert durch das Faktum, dass das griechische Denken der Antike mit ›physis‹ das Seiende als solches und im Ganzen bezeichnet. Vetter schreibt dazu: »Was sie [= die Griechen] damit

marrë në vetvete, kuptohen mirë, dhe në zbatimin e tyre gramatikor mund të jenë vërtet të panjohura, por megjithatë të kuptueshme. Ajo që e bën të vështirë për t'i kuptuar fjalët e tij të reja gjermane, është zbatimi i tyre retorik. Hajdegeri tenton pikërisht që ta minojë tendencën reifikuese të gjuhës – e cila, që ta formulojmë në mënyrë kritike, përpiqet të emërtojë diçka si Diçka – dhe të flasë për fenomenin e të qenmes në një mënyrë jo-reifikuese. Në këtë mënyrë ndodhin formulime të çuditshme, të cilat disa i kanë quajtur në mënyrë gjysëm përshekruese dhe gjysëm nënvleftësuese si “hajdergeroj” (si folje). Pa marrë parasysh se çfarë qëndrimi marrim karshi kësaj, retorika speciale e të qenmes e Martin Hajdegerit tregon se sa shumë ka luftuar ai me gjuhën tradicionale.

Në këtë kontekst po i sjell dy shembuj – ndoshta të njohur – të përkthimeve filozofike të nocioneve antike greke në gjermanisht. Së pari, fjala ‘physis’. Këtu bëhet fjalë për një ‘emër’ të ashtuquajtur ‘deverbativ’, pra për një emër substantiv, i cili rrjedh nga një folje, nga ‘phyein’, që do të thotë ‘dal, krijon, zhvillon, rritet’. Përkthimi i korrekt latin është ‘natura’, dhe kështu ka ardhur edhe në gjuhët moderne: Natur, nature (en, fr), natura (at, pt, sp) etj. Duke folur nga pikëpamja moderne, natyra kuptohet si kontraritet sidomos me ‘artin’ ose me ‘mendjen’. Por, ajo gjithashtu ka kuptimin e natyrën së një gjëje, thelbin e një gjëje. Dhe sapo të flasim për ‘thelbin’, gjendemi mu në mesin e retorikës së Hajdegerit për të qenmen.

Natyrë, pra ‘physis’ nuk është thjesht si një objekt (natyror), por pikërisht duke pasur ‘physis’ prejardhje nga një folje, pra nga një fjalë, një shprehje gjuhësore, e cila emërton një ngjarje, një zbatim, atëherë është e qartë se ajo që synohet me një përcaktim nominalist të nocionit, i cili në kuptimin e fjalës synon një një de-finicion, një përkufizim, nuk na çon përpara për të kuptuar më mirë. Pra, mund të ekzistojë vetëm koncepti i ‘physis’, i cili e thekson fleksibilitetin e fenomenit, karakterin e saj të zbatimit. Kjo komplikohet edhe me faktin se mendimi

meinen, erschließt sich ihnen ursprünglich ›aufgrund einer dichtend-denkenden Grunderfahrung‹: Physis als ›das aufgehende Walten und das von ihm durchwaltende Währen‹, ›das Ent-stehen, aus dem Verborgenen sich heraus- und dieses erst in den Stand bringen‹.« (Vetter, S. 325, zitiert hier GA 40, 17.) Diese Ausdrücke sind ein gutes Beispiel für Heideggers Rhetorik des Seins: Er verweigert sich der einfachen alltagssprachlichen Gleichung ›Physis ist (gleich)‹ (Gleichung durchaus im mathematischen Sinn zu verstehen) und versucht, den verbalen (NICHT: nominalen) Wortursprung auch im Deutschen beizubehalten. Dafür verwendet er die nur mehr in Zusammensetzungen geläufigen Verben »walten« und »währen«. »Walten« bedeutet stark sein, bestehen, da sein, nicht zur Seite rücken, führen, herrschen, bestimmen – je nach Verwendungszusammenhang. Es drückt also etwas Beständiges aus, etwas worauf man sich verlassen kann. Dazu gehört auch der zeitliche Aspekt: »währen« heißt dauern, andauern, über eine gewisse Zeit hin bestehen. In Bezug auf Heideggers Auslegung des Begriffs ›physis – Natur‹ bedeutet das, dass er versucht, einem Paradoxon eine nicht-widersprüchliche sprachliche Form zu geben: Physis sei etwas, das sich zwar in einer aufgehenden Bewegung befindet, dass diese zugleich aber auf eine beständig-dauernde Weise uns beherrscht, wenn nicht sogar die Welt, das Sein im Ganzen ausmacht. Das Phänomen des so verstandenen Seins mit Hilfe einer klassischen Definition, sprich: Begriffsbestimmung zu beschreiben, kann nur zu kurz greifen. Hier kommt die deutsche Sprache offensichtlich an ihre Grenzen, weil sie nur das Verb ›sein‹ zur Verfügung hat.

---

Bevor ich das zweite Beispiel erläutere, will ich noch einen kurzen sprachlichen Exkurs geben. – Die romanischen Sprachen, soweit ich sie spreche bzw. überblicke, haben für die verschiedenen Seinsaspekte

grek i antikitetit me ‘physis’ emërton entitetet si të tilla dhe si tërësi. Vetter shkruan lidhur me këtë: “Ajo që ata [= grekët] nënkuptojnë më këtë nocion, fillimisht iu zbulohet ‘për shkak të një përvojë themelore poetikomenduese’: physis si “sundim që del dhe si qëndrim që sundohet nga ajo”, si ‘krijim që del vet nga e fshehura dhe që vetëm kjo e sjell këtë të fshehur në dukje’ “(Vetter, 325, citon këtu GA 40, 17) Këto shprehje janë një shembull i mirë i retorikës së të qenmes: Hajdegeri refuzon ekuacionin e thjeshtë të gjuhës së përditshme ‘Physis është (e barabartë)’ (ekuacion ky plotësisht në kuptimin matematikor) dhe përpiket ta ruajë edhe në gjermanisht origjinën verbale të fjalës (JO: atë nominale). Për këtë ai përdor vetëm foljet tani të zakonshme vetëm në fjalë të përbëra “sundoj” (gjerm. “ëalten”) dhe “qëndroj” (gjerm. “ëähren”). “Sundoj” (gjerm. “ëalten”) do të thotë të jesh i fortë, qëndroj, të jesh i pranishëm, të mos kalosh anash, udhëheq, zotëroj, vendos – në varësi të kontekstit të përdorimit. Ajo shpreh pra diçka të qëndrueshme, diçka në të cilën ju mund të mbështetemi. Kjo përfshin edhe aspekti kohë: “qëndroj” do të thotë vazhdon, ka jetë të gjatë, qëndron për një kohë të caktuar. Lidhur me interpretimin Hajdegerit për konceptin ‘physis – natyrë’ kjo do të thotë se ai është duke u përpjekur për t’i dhënë një paradoksi një formë jo-kontradiktore gjuhësore: physis sipas tij është diçka që edhe pse është në një lëvizje në rritje, se kjo në të njëjtën kohë na sundon në një mënyrë të zgjat në mënyrë të qëndrueshme, nëse jo botën që e përbën të qenmen si tërësi. Fenomeni i të qenmes i kuptuar në këtë mënyrë me ndihmën e një përkufizimi klasik, që është: përskrimi i një përkufizimi, është i pamjaftueshëm. Këtu gjuha gjermane padyshim ka kufijtë e saj, sepse ajo ka në dispozicion vetëm foljen ‘jam’ (Gjerm. ‘sein’).

---

Para se të shpjegoj shembullin e dytë, dua të jap një digresion të shkurtër gjuhësor. – Gjuhët romane, aq sa unë i flas apo aq sa e kuptoj këtë gjë, për aspekte të ndryshme të së qenmes kanë fjalë të ndryshme



verschiedene Worte und müssen sich nicht mit anderen Wörtern oder etwa Hilfskonstruktionen behelfen.

Italienisch:

essere, esserci, restare, esistere, stare, fare (mit Berufsbezeichnung)

-----

Portugiesisch:

ser, estar, ficar, existir, haver

-----

Spanisch:

ser, hallarse, estar, haber (als Hilfsverb), quedar

Auch wenn es unter diesen Worten, die auf Deutsch alle ›sein‹ bedeuten können, welche geben mag, die im Deutschen gebräuchlich sind (stehen, bleiben, machen), so haben sie hier in erster Linie nicht mit ›sein‹ zu tun, beispielsweise das portugiesische ›estar‹. Wenn man so will, sind die romanischen Sprachen in diesem Punkt differenzierter als das Deutsche. Das zu entscheiden scheint mir nicht relevant zu sein, und es kommt mir hier auch nicht darauf an. Mir geht es darum zu zeigen, dass Heidegger die Bedeutungsvielfalt, die im deutschen Infinitiv ›sein‹ liegt, sehr genau gesehen hat. Damit endet der Exkurs und leitet über zu einem weiteren Terminus, der in Heideggers Philosophie wichtig ist: Technik.

---

Technik kommt von *téchne* und heißt zunächst ›Kunst‹. Heidegger (GA 19) bezieht sich auf Aristoteles' Nikomachische Ethik (1139b15), in der *téchne* eine der fünf Arten des *aletheuein*, des Entdeckens ist: »Die Mittel, mit denen die Seele bejahend oder verneinend die Wahrheit trifft, seien fünf an der Zahl: Kunst [= *téchne*], Wissenschaft, Klugheit, Weisheit, Geist« (Übers.: O. Gigon). Heidegger (GA 19, 22) hingegen übersetzt: »Weisen, in denen das menschliche Dasein als Zu- und

dhe nuk kanë nevojë të kërkojnë ndihmë nga fjalë të tjera, ose edhe nga konstruksione ndihmëse.

Italisht:

essere, esserci, restare, esistere, stare, fare (me profesion)

-----

Portugalisht:

ser, estar, ficar, existir, haver

-----

Spanjollisht:

ser, hallarse, estar, haber (si folje ndihmëse), quedar

Edhe pse mund të jetë që në këto fjalë, të cilat në gjuhën gjermane të gjitha kanë kuptimin e 'jam' (gjerm. 'sein'), mund të keë ndonjë prej tyre që përdoren në gjuhën gjermane (qëndroj, rri, bëj), ato megjithatë këtu nuk kanë të bëjnë në radhë të parë me kuptimin e 'jam' (gjerm. 'sein'). Nëse ju pëlqen, gjuhët romane në këtë pikë janë më të diferencuara se sa gjuha gjermane. Nuk më duket e rëndësishme të vendosim nëse është kështu apo jo, dhe për mua këtu s'është me rëndësi një vendim i tillë. Këtu jam i interesuar të tregoj se Hajdegeri e ka shikuar shumë saktë diversitetin që është në paskajoren gjermane 'për të qenë'. Kështu përfundon digresioni që e bëra dhe na çon në një shprehje tjetër, e cila është e rëndësishme në filozofinë e Hajdegerit: teknika.

---

Teknika vjen nga fjala *téchne* dhe fillimisht do të thotë "art". Hajdegeri (GA 19) i referohet etikës së Nukomahut të Aristotelit (1139b15), ku *téchne* është një nga pesë llojet e *aletheuein*, pra, zbulimit: "Mjetet, me të cilat shpirti e qëllon të vërtetën në mënyrë pohuese ose mohuese, janë pesë në numër : irti [= *téchne*], shkenca, maturia, urtësi, mendja" (përkth.: O. Gigon). Kurse Hajdegeri (GA 19, 22) përkthen: "Mënyrat, në të cilat ekzistenca e këtushme (gjerm.

Absprechen das Seiende erschließt [...]«. Aletheuein als »das Seiende erschließen« – das ist definitiv etwas anderes als »die Wahrheit treffen«. Im Werk Heideggers wird an vielen Stellen der Begriff ›téchne‹ für ›Kunst‹ eingehend reflektiert, der meines Erachtens diesbezüglich eindrücklichste Text ist sein Athener Vortrag von 1967 »Die Herkunft der Kunst und die Bestimmung des Denkens« (in: Denkerfahrten). Darin wird nämlich seine Rhetorik des Seins, so wie ich sie verstehe, deutlich.

Heidegger nimmt eingangs Bezug auf die Stadt Athen, die nach der Göttin Athene benannt ist. Er ruft Homer als Zeugen an, um festzustellen, was Athenes Aufgabe (gewesen) sei: vorzudenken, vorzusagen, etwas ans Licht bringen, etwas gelingen lassen – bei Homer mit dem Ausdruck ›polymetis‹ bezeichnet. Diejenigen, die das in der Welt der Menschen (nicht in der der Götter) tun, sind die sogenannten ›technítes‹, die Handwerker, diejenigen, die geschickt im Herstellen sind, die etwas gelingen lassen: nicht nur die Handwerker, auch die Architekten und die Künstler. Heidegger sagt: »[...] ihr maßgebendes Tun [ist] durch ein Verstehen geleitet [...], das den Namen téchne trägt. Das Wort nennt eine Art des Wissens. Es meint nicht das Machen und Verfertigen. Wissen aber heißt: Jenes zuvor im Blick haben, worauf es im Hervorbringen eines Gebildes und Werkes ankommt.« (Denkerfahrten, 137)

Unter dem Aspekt von »Rhetorik des Seins« fällt auf: Heidegger sagt NICHT ›téchne IST eine Art des Wissens‹; Heidegger sagt NICHT ›téchne IST das Machen und Verfertigen‹; Heidegger sagt NICHT ›Wissen IST etwas im Blick haben, worauf es im Hervorbringen [...] ankommt‹. Er sagt vielmehr »nennen«, »heißen«, »meinen« – alle diese Verben sind Synonyme für »sprechen«. Es ist also mehr als nur angebracht, diese Wortwahl in rhetorischer Hinsicht zu betrachten. Zudem muss gesagt werden, dass Heidegger mit Sicherheit bewusst war, dass man sich als Leser/Hörer dieses Texts das Verb »sein« statt

Dasein) njerëzore e zbulon entitetin (gjerm. Das Seiende) si pranim apo mohim [...]”. Aletheuein si “zbulim i entitetit”, – kjo është patjetër diçka tjetër sesa “qëllimi i së vërtetës”. Në shumë fragmente të veprave të Hajdegerit nocioni ‘téchne’ është reflektuar në thellësi për ‘art’, dhe sipas mendimit tim në këtë drejtim teksti më i rëndësishëm është Leksioni i tij i Athinës 1967 “Origjina e artit dhe përcaktimi i mendimit” (në: përvojat e të menduarit). Aty bëhet e qartë retorika e tij e të qenmes, siç e kuptoj unë.

Hajdegeri fillimisht bën lidhjen me qytetin e Athinës, i cili ka marrë emrin në bazë të perëndeshës Athene. Ai e thërret Homerin si dëshmitar, për të konstatuar se çfarë detyre ka pasur Athene: të menduar paraprakisht, për të planifikuar, për të sjellë diçka në dritë, për të bërë që diçka të ketë sukses, – që te Homeri shprehet me shprehjen ‘polymetis’. Ata që bëjnë këtë në botën e njerëzve (jo të perëndive), janë të ashtuquajturit ‘technites’, zejtarët, ata të cilët janë të aftë në prodhim, të cilët bëjnë që diçka të dalë në dritë me sukses: dhe jo vetëm zejtarët, edhe arkitektët dhe artistët. Hajdegeri thotë: “[...] veprimi i tyre kompetent udhëhiqet nga një kuptim [...], që mban emrin téchne. Kjo fjalë emërton një lloj të diturisë. Kjo nuk nënkupton bërjen dhe prodhimin. Dija është: Atë duhet pasur më parë në mendje, çka është e rëndësishme në krijimin e një strukture dhe veprë“ (Denkerfahrten, 137).

Nën aspektin e “retorikës së të qenmes” bie në sy se: Hajdegeri NUK thotë ‘téchne është një lloj i dijes’; Hajdegeri NUK thotë se ‘téchne ËSHTË bërja dhe prodhimi’; Hajdegeri NUK thotë ‘dija ËSHTË kur duhet pasur diçka në mendje që është e rëndësishme për prodhim [...]’. Ai në vend të kësaj thotë “quan”, “thotë”, “nënkupton” – të gjitha këto folje janë sinonime për fjalën “të flasësh”. Pra, është më shumë se vetëm e përshtatshme ta shqyrtojmë këtë përzgjedhje të fjalëve nga aspekti retorik. Duhet të thuhet gjithashtu se Hajdegeri ishte me siguri në dijeni se dikush si lexues/dëgjues i këtij teksti më shumë do të priste

»nennen«, »heißen«, »meinen« erwartet hätte, entspricht das doch dem alltäglichen Sprachgebrauch im Deutschen. Und was die Rhetorik angeht, so will ich einfach nur diesen einen Satz aus demselben Absatz, den ich eben zitiert habe, wiedergeben, der für sich spricht: »Das Werk kann auch ein solches der Wissenschaft und der Philosophie, der Dichtung und der öffentlichen Rede sein.« (ebd.) Das Resümee dieses Absatzes lautet: »Die Kunst ist *téchne*, aber keine Technik. Der Künstler ist *technítes*, aber weder Techniker noch Handwerker.« (ebd.)

Wenn wir uns die vorhin zitierte Aristoteles-Stelle vergegenwärtigen und auf die Künstler beziehen, dann scheint klar, dass sie uns das Seiende erschließen, indem sie ihre dichtend-denkerische Grunderfahrung mitteilen: Angesichts ihrer Werke machen wir Erfahrungen, geht uns etwas auf. Diesem ›Aufgehen‹ sind wir bereits begegnet: im Phänomen der ›*physis*‹. Und folgerichtig stellt Heidegger im Vortrag die Verbindung zwischen *Physis* und *Téchne* her: »Die Kunst entspricht der *physis* und ist gleichwohl kein Nach- und Abbild des schon Anwesenden. *Physis* und *téchne* gehören auf eine geheimnisvolle Weise zusammen. Aber das Element, worin *physis* und *téchne* zusammengehören, und der Bereich, auf den sich die Kunst einlassen muß, um als Kunst das zu werden, was sie ist, blieben verborgen.« (S. 139) Dieser Bereich ist die Wahrheit, die *alétheia*, die ›Unverborgenheit‹ (so übersetzt Heidegger *alétheia*). Wahrheit als Unverborgenheit ist bei Heidegger immer eng mit Sein verknüpft, gerade auch weil er in Situationen, wo man Definitionen, also Ist-Aussagen erwartet, diese verweigert. Der Grund dafür liegt in der Sachangemessenheit der sprachlichen Bezeichnung für das je in Frage stehende Phänomen. Um dieses in seinem So-Sein zu zeigen, um es in die Unverborgenheit zu bringen, um es zu entbergen, ist es für ihn notwendig, gleichzeitig das »Geheimnis« zu bewahren – also bei der Phänomenbestimmung das Sein des Phänomens sprachlich indirekt auszudrücken. Man könnte es das Paradoxon des »Sinns vom Sein« nennen: Man spricht den Sinn des Seins aus, indem man das, was einem gegeben ist und zu

folgen "jam" në vend të "quan", "thotë", "nënkupton", kjo pikërisht korrespondon me të folmen e përditshme në gjuhën gjermane. Sa për retorikën, dua ta riprodhoj thjeshtë edhe atë fjali nga i njëjti paragraf që kam cituar tashmë, i cili flet për veten: "Vepra mund të jetë edhe një e tillë e shkencës dhe filozofisë, e poezisë dhe të folurit publik." (ibid.). Përmbledhja e këtij paragrafi është: "Arti është *téchne*, por jo teknikë. Artisti është *technítes*, por as teknik e as zejtar." (Ibid.)

Nëse e kujtojmë paragrafin e cituar më parë të Aristotelit dhe i referohemi artistëve, atëherë duket qartë se ata na zbulojnë entitetin, duke na kumtuar përvojën e tyre themelore poetiko-mendimore: Duke pasur parasysh veprat e tyre ne bëjmë përvoja dhe na hapen sytë për diçka (gjerm. 'geht uns etwas auf'). Këtë "çelje e syve" e kemi hasur tashmë: në fenomenin e 'physis'. Dhe logjikisht Hajdegeri në atë ligjëratë e bën lidhjen midis *Physis* dhe *Téchne*: "Arti korrespondon me *physis*-in dhe megjithatë nuk është kopje dhe pasqyrë e tashmë të të pranishmes. *Physis* dhe *téchne* përkasin së bashku në një mënyrë misterioze. Por, elementi në të cilin përkasin së bashku *physis* dhe *téchne*, dhe fusha, me të cilën duhet të merret arti, në mënyrë që si art të bëhet ajo që është, mbeten të fshehura". (Fq. 139) Kjo fushë është e vërteta, *alétheia*, e pafshehura (siç e përkthen Hajdegeri fjalën *alétheia*). E vërteta si e pafshehura te Hajdegeri është gjithmonë e lidhur ngushtë me të qenmen, veçanërisht edhe për shkak se ai në situata ku priten definicionet, pra pohimet deskriptive (gjerm. 'Ist-Aussagen'), i mohon ato. Arsyeja për këtë qëndron në përshtatshmërinë objektive të emërtimit gjuhësor për fenomenet në pyetje. Për të treguar këtë në mënyrën e tij të të qenit (gjerm. 'In seinem So-Sein') e tij, për ta sjellë atë në të pafshehurën, për ta zbuluar atë, është për të e nevojshme që njëkohësisht ta ruajë "misterin" – dmth. që gjatë përcaktimit të fenomenit ta shprehë të qenmen e fenomenit në mënyrë të tërthortë me anë të gjuhës. Këtë mund ta quajmë paradoksi i "kuptimit të së qenmes": Ne s shprehim kuptimin e së qenmes duke e

beschreiben und zu bestimmen aufgegeben ist, mit Worten versieht, die das im Deutschen so wichtige Verbum ›sein‹ zu vermeiden suchen. Den Sinn von Sein aussprechen, ohne das feststellende (fest-stellende) Wort ›sein‹ zu verwenden: Das könnte man als den Kern von Heideggers Rhetorik des Seins bezeichnen.

(4)

In »Sein und Zeit« versucht Heidegger den »Sinn von Sein« zu verstehen und zu klären, indem er denjenigen befragt, der immer schon Sein irgendwie versteht: den Menschen, den er im Buch durchgehend »Dasein« nennt. Es geht Heidegger dabei um ein Verstehen von Sein und nicht um ein Erkennen, wie das beispielsweise bei Kant der Fall ist, wenn dieser nach dem Erkenntnisvermögen des Subjekts fragt. Hinter das Verstehen kann das Denken nicht zurückgehen, denn Sinn ist etwas stets schon Vorangehendes, er kann nicht nachträglich durch Zusammenfügen von zwei zunächst getrennten, beziehungslosen, das heißt sinnlosen Dingen hergestellt werden. Wir als »Dasein« haben sozusagen immer schon verstanden. Den »Sinn von Sein« zu verstehen kann daher nur durch das Eintreten in einen hermeneutischen Zirkel gelingen, um in kreisenden Bewegungen, die sich vom Einzelnen zum Ganzen bewegen und zurück, den Sinn von Sein freizulegen. Diesen Zirkel zu vollziehen habe ich mit meinem Vortrag versucht.

Das eben erwähnte Einzelne ist der Mensch, das Dasein; das ihm gegebene Ganze ist seine Existenz und die Welt in ihrer Welthaftigkeit. Mit Welthaftigkeit oder Weltlichkeit meint Heidegger die grundlegenden Sinnstrukturen der Welt (beispielsweise etwa die Nützlichkeit von Werkzeugen, die Zeughaftigkeit von Zeug; vgl. dazu seinen »Kunstwerkaufsatz«, GA 5, 13–22). Heidegger will in »Sein und Zeit« die Existenzialien, also die den Menschen grundlegend bestimmenden Strukturen, freilegen. Ist dies einmal als Grundlage gewonnen, soll im

pajisur me fjalë atë që na jepet dhe që na është dhënë për detyrë ta përshkruajmë dhe ta përcaktojmë, fjalë ato që përpiqen ta shmangin foljen aq të rëndësishme në gjermanishte 'jam'. Të shprehet kuptimi i të qenmes pa e evituar fjalën konstatuese 'për të qenë': Këtë mund ta quanim thelbin e retorikës së të qenmes te Hajdegeri.

(4)

Në veprën "E qenmja dhe koha" Hajdegeri përpriqet ta kuptojë dhe ta sqarojë "kuptimin e të qenmes" duke e pyetur atë që gjithmonë e ka kuptuar në njëfarë mënyre të qenmen: njeriun, të cilin ai në mënyrë të vazhdueshme në libër e quan "e qenme e pranishme" (gjerm. "Dasein"). Për Hajdegerin aty është fjala për të kuptuarit, e jo për njohje siç e kemi për shembull te Kanti, kur ky pyet për kapacitetet e njohjes. Pas të kuptuarit, mendimi nuk shkon prapa, pasi kuptimi është diçka që shkon gjithmonë para, ai nuk mund të krijohet më vonë me anë të bashkimit të sendeve të dnara, që s'kanë lidhje, do të thotë të pakuptimta. Ne si "e qenme e pranishme" pothuajse tashmë kemi kuptuar gjithmonë. Të kuptuarit e "kuptimit të qenmes" mund të ketë sukses, pra, vetëm me futjen në një qark hermeneutik, në atë mënyrë që të ekspozohet kuptimi i të qenmes në lëvizje rrethore, të cilat lëvizin nga individualja te gjeneralja dhe anasjelltas. Në këtë prezantim jam përpjekur ta bëj këtë qark.

Individi i posapërmendur është njeriu, Dasein-i; ajo që i është dhënë atij në tërësi është ekzistenca e tij dhe bota në natyrën e saj të botës. Me natyrën e botës apo me botësinë Hajdegeri nënkupton strukturat kuptimore të botës (për shembull, dobinë e instrumenteve, të qenit pajisje e një pajisjeje; cf. lidhur me këtë në artikullin "Kunstëerk" GA 5, 13–22). Hajdegeri dëshiron t'i ekspozojë në "E qenmja dhe koha" ekzistencalet, pra strukturat që e përcaktojnë njeriun në themel. Pasi të jetë marrë kjo si bazë, më pas duhet prap t'i përgjigjemi pyetjes, si

Anschluss daran wiederum die Frage beantwortet werden, wie sich durch diese Grundlage die Welt verstehen lässt. Die Antwort wäre diese: Es ist die Sprache, die idealerweise sachangemessen ist. Das bedeutet, dass sie weder sich selbst, noch dem, was durch sie bezeichnet wird, den Vorrang gibt. Sein und Seiendes kommen zugleich in und mit der Sprache vor, sie sind durch sie. Niemand hat das so treffend formuliert wie Cicero: »Denn da sich jede Rede aus der Sache und der Formulierung zusammensetzt, kann einerseits die Formulierung keine Basis haben, wenn man die Sache wegnimmt, andererseits fehlt der Sache die Erhellung, wenn man die Formulierung von ihr trennt.« (De or. III. 19: »Nam cum omnis ex re atque verbis constet oratio, neque verba sedem habere possunt, si rem subtraxeris, neque res lumen, si verba removeris.«)

## Literatur

**Aristoteles:** *Die Nikomachische Ethik* (Übers. Olof Gigon), München: dtv 1981 (4. Auflage)

**Cicero:** *De oratore / Über den Redner* (zweisprachig, Übers. Harald Merklin), Stuttgart: reclam 1997 (4. Auflage)

**Martin Heidegger** (GA = Gesamtausgabe, Frankfurt am Main: Vittorio Klostermann):

GA 2 = *Sein und Zeit*. 1977

GA 4 = *Erläuterungen zu Hölderlins Dichtung*, 1981

GA 5 = *Holzwege* (darin: »*Der Ursprung des Kunstwerkes*«), 1977

GA 7: *Vorträge und Aufsätze* (darin: »*Das Ding*«), 2000

mund të kuptohet bota përmes kësaj baze. Përgjigja do të ishte kjo: Gjuha është ajo, e cila është në mënyrë ideale e përshtatshme objektivist. Kjo do të thotë se ajo nuk i jep prioritet as vetes së vet, e as asaj që emërton ajo. E qenmja dhe entiteti ndodhin njëkohësisht në dhe me gjuhën, ato janë nëpërmjet saj. Askush nuk e ka formuluar në mënyrë të qëlluar si Cicero: “Sepse pasi që çdo fjalim përbëhet nga çështja dhe formulimi, formulimi në njërin anë nuk mund kanë asnjë bazë, në qoftë se i heqet materia (apo çështja), në anën tjetër çështjes i mungon drita, nëse e ndajmë formulimin nga ajo” (De or. III. 19: “Nam cum omnis ex re atque verbis constet oratio, neque verba sedem habere possunt, si rem subtraxeris, neque res lumen, si verba removeris.”)

GA 8: *Was heißt Denken?* 2002

GA 9: *Wegmarken.* 1976

GA 14: *Zur Sache des Denkens.* 2007

GA 19 = *Platon: Sophistes*, 1992

GA 34 = *Vom Wesen der Wahrheit. Zu Platons Höhlengleichnis und Theätet*, 1988

GA 40 = *Einführung in die Metaphysik*, 1983

GA 52 = *Hölderlins Hymne »Andenken«*, 1982

GA 61 = *Phänomenologische Forschungen zu Aristoteles. Einführung in die phänomenologische Forschung*, 1985

Denkerfahrten = *Denkerfahrten 1910–1976*, Frankfurt am Main: Vittorio Klostermann 1983

Helmuth Vetter: *Grundriss Heidegger*. Hamburg: Felix Meiner 2014

*Vortrag auf der internationalen Tagung »Two Philosophers of Being: Mulla Sadra and Martin Heidegger« auf Einladung des Ibni Sina Institute / Prishtina und der Kosovo Philosophical Association in Prishtina/Kosovo, 18. Mai 2016*